

2064



Res Publica <qendra.respublica@gmail.com>

137/11

Kthim pergjigje kerkeses nr. 137/22

Elvira Gaxholli <elvira.gaxholli@kqz.gov.al>

Thu, Sep 22, 2022 at 12:09 PM

To: "qendra.respublica@gmail.com" <qendra.respublica@gmail.com>

Përshëndetje,

Si më poshtë vijon, gjeni kthim pergjigjen në lidhje me kërkesën tuaj nr. prot 137/22 .

"I nderuar z. Matlija,

Në pergjigje të kërkesës suaj me nr. prot. 137/22, datë 12.09.2022, me objekt "Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion e dokumentacionit", dërguar elektronikisht pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ju sqarojmë si më poshtë vijon:

Në referim të nenit 13, pika 1, të ligjit nr. 54/2019 "Për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë", periudha kohore për mbledhjen e nënshkrimeve caktohet me propozimin e përfaqësuesve të nismës dhe miratimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ky propozim paraqitet në KQZ së bashku me kërkesën me shkrim për miratimin e fletës tip për mbledhjen e nënshkrimeve dhe miratohet prej tij, 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e paraqitjes së kërkesës.

Referuar pikës 2 të kërkesës, neni 14, pika 1, e ligjit nr. 54/2019, e përcakton shprehimisht se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikon nënshkrimet, si dhe saktësinë e dokumenteve identifikuese të mbështetësve të nismës, sipas procedurave të parashikuara në Kodin Zgjedhor për verifikimin e nënshkrimeve dhe në legjislacionin në fuqi për nënshkrimin elektronik.

Sa i përket pikës 3 dhe 4 të kërkesës suaj, neni 7 i ligjit nr. 54/2019 përcakton se shpenzimet për përgatitjen e fletëve të mbledhjes së nënshkrimeve, si dhe për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve përballohen nga përfaqësia/komiteti përfaqësues i nismës ligjvënëse. Nismëtarët përcaktojnë paraprakisht mënyrën e mbulimit të shpenzimeve, si dhe të çdo shpenzimi tjetër të nevojshëm për nismën ligjvënëse, nëpërmjet memorandumeve të bashkëpunimit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi përgjegjës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e financimit të partive politike. Referuar ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar, ndalohet ndihma financiare dhe materiale nga qeveri dhe nga ente publike ose private të huaja, si dhe nga ente vendase publike ose me pjesëmarrje të kapitalit shtetëror. Subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre mund të marrin fonde për qëllime të fushatës së tyre zgjedhore vetëm nga persona fizikë ose juridikë vendas. Gjithashtu partitë politike duhet të hapin llogari të posaçme dhe ta deklarojnë atë në momentin e regjistrimit të tyre në KQZ, llogari e cila shërben për dhurimet/kontributet e marra nga personat fizikë ose juridikë vendas.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,"